

**DOKUMENTET QË MBËSHTESIN  
KËRKESËN TUAJ MUND TË PËRFSHI-  
JNË ÇDONJËRËN PREJ KËTYRE**



- Kontrata e shitblerjes
- Fleta poseduese
- Vendimi i gjykatës mbi përcaktimin e të drejtës pronësore
- Deklarata e nënshkruar nga ana e shitësit ose dëshmitarit
- Kopja e Planit Kadastral
- Çertifikata Kadastrale ose dokumente tjera kadastrale
- Vendimi mbi Ndarjen
- Kontrata mbi Shfrytëzimin
- Marrëveshja mbi Qiranë
- Vendimi mbi Trashëgiminë në rast se pronari i pronës ka vdekur
- Faturat e shërbimeve komunale
- Të dhënat Tatimore
- Leja e përkohshme e lëshuar nga ana e organeve publike ose bartësit të së drejtës pronësore.
- Ose çfarëdo dokumenti tjetër i cili dëshmon të drejtën tuaj pronësore.

**Beograd**

Kosovska 49/8

Tel: 011 334 5513 ose 334 5314 Fax: 011 334 4452

**Gjilan**

Rade Popovic/Washington Street

Tel: 0280 320 289 - fax: 0280 324 067

**Kragujevc**

9, "Llolla Ribar" Rr. Kati 3të

Tel: 034 330-234; 330-784

**Mitrovicë**

Pjesa jugore: rr. Mbretëresha Teuta (përballë Jugobankës)  
028 530 136 and 530 137 - fax: 028 530 139

Pjesa Veriore: rr. Filip Vishnjq No. 4, Dhoma No. 18 (ish  
Ndërtesa e AKM), Stacioni Verior i Policisë  
Tel: 063 197 6470 - fax: 028 530 139

**Nish**

rr. "Dusanov Bazar" (Dusanova) Kati 3të, Zyrja No. 308

Tel: 018 515-727; 515-728

**Pejë**

rr. Mbretëresha Teuta, Nr. 85

Tel: 039 431 668, 039 432 968

fax: 039 432 970

**Podgoricë**

Crnogorskih Serdara

Tel: 081 624 216

**Prishtinë**

Qendër: Rexhep Luci 28/rr. Goleshit 2 Tel: 038 225 473 - fax:  
038 244 854 Graçanicë: Prapa ndërtesës së komunës Tel: 038  
225 473

**Prizren**

Jeronim Derada (ish Zef Mark Lushi/Metohisë) No. 63/A

Tel: 038 504 604 8046/8024 - fax: 029 631 429

**Shkup**

rr. Vinička No. 10 (ndërtesa CDRIM),  
kati i 1rë

Tel: +389 22 656 291

**E PËRKRAHUR NGA**



[mailbox@kpaonline.org](mailto:mailbox@kpaonline.org)



**Agjencia Kosovare e Pronës**



**Afati** i fundit për  
paraqitjen e  
kërkesave

**03.12.2007**

[www.kpaonline.org](http://www.kpaonline.org)

## KUSH JEMI NE – AGJENCIA KOSOVARE E PRONËS?

Agjencia Kosovare e Pronës (KPA) është themeluar më 4 mars 2006 si Agjenci e pavarur me mandat për zgjidhur kërkesat mbi humbjen e pronësisë mbi pronat private të patundshme si rrjedhojë e konfliktit të armatosur të vitit 1998-1999. Kjo përfshinë pronat e banimit, komerciale si dhe ato bujqësore.

## ÇFARË LLOJ KËRKESASH MUND TË ZGJIDHË KPA-ja?

KPA-ja mund të zgjidhë kërkesat mbi humbjen e pronësisë mbi pronën private të patundshme, të cilat përfshijnë

- pronësinë; ose
- të drejtat e shfrytëzimit

që janë rrjedhojë e konfliktit të armatosur të vitit 1998-1999 dhe ku paraqitësi i kërkesës nuk mund të rikthejë vet pronësinë.

## ÇFARË LLOJ KËRKESASH KPA-ja NUK MUND TË ZGJIDHË:

Si pasojë e mandatit statusor të KPA-së, agjencia nuk ka juridiksion mbi kërkesat për:

- Humbjen e posedimit mbi pronën e cila nuk është pasojë e konfliktit të armatosur të vitit 1998-1999 (p.sh. nacionalizimi i mëparshëm);
- Pronë tjetër përpos asaj private (p.sh. ndërmarrje shoqërore dhe vjedhje të tundshmërive);
- Kompensim për dëmtim, shkatërrim ose shfrytëzim të paautorizuar të pronës private - ose ndihmë në rindërtim;

## SI TË BËHET KËRKESA?



Ju mund të bëni kërkesën personalisht, përmes ndonjë anëtarit të familjes së ngushtë (gruaja, prindët, gjyshi/gjyshja, fëmijët, nipi/mbesa, vëllai, motra) ose përfaqësuesi ligjor të autorizuar nëse ai ka Autorizim të plotfuqishëm. Për të bërë këtë, ju lutem kontaktoni zyret tona për pranim të kërkesave që të caktoni takim. Lokacioni dhe hollësitë për kontaktim të zyrave tona janë listuar në faqen e prapme të kësaj fletë-palosjeje.

Kur të vini në zyren tonë ju duhet të sillni me vete të gjitha dokumentet që posedoni ose që mund t'i merrni, dhe të cilat vërtetojnë ose mbështesin të drejtën tuaj pronësore. Edhe nëse nuk keni dokumente ju mund të bëni kërkesë dhe KPA-ja do të kërkojë ato në regjistrat publike të pronave.

Kur të vini në KPA një punonjës yni do të marrë hollësitë nga ju dhe do t'ju ndihmojë të bëni kërkesën. Nëse sillni dokumente, ne do të bëjmë fotokopjimin e tyre dhe origjinali do t'ju kthehet juve menjëherë pasi që ne nuk mbajmë origjinalin.

## SI DO TË PËRPUNOHET LËNDA?



KPA-ja do të publikojë kërkesën tuaj, do të njoftojë banorin aktual për kërkesën tuaj dhe do t'u lejojë të tjerëve të cilët pretendojnë ndonjë të drejtë ligjore mbi pronën të marrin pjesë në procedurë.

Kërkesa juaj do hulumtohet individualisht. Kjo përfshinë verifikimin e dokumenteve dhe hulumtimin në regjistrat publik të pronave.

Pas hulumtimit të plotë të kërkesës suaj ajo do t'i prezentohet Komisionit të Pavarur për Kërkesa Pronësore të Kosovës për vendim.

## SI DO TË VENDOSËT PËR KËRKESËN?



Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës do të lëshojë vendim me të cilin pranon ose refuzon kërkesën tuaj. Nëse nuk pajtoheni me vendimin, keni të drejtë ankese pranë Gjykatës Supreme të Kosovës.

Vendimet përfundimtare të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës ose në rast të ankesës, vendimet e Gjykatës Supreme të Kosovës, janë të detyrueshme dhe të imponueshme dhe nuk do të rishqyrtohen nga asnjë autoritet tjetër ligjor ose administrativ në Kosovë.

KPA-ja do të implementojë vendimin në përputhshmëri me kërkesën e juaj.

**Ju lutemi paraqitni kërkesë  
deri më:  
03 Dhjetor 2007**

[www.kpaonline.org](http://www.kpaonline.org)